



FAKULTETI JURIDIK

PROGRAMI STUDIMOR PËR STUDIME PASUNIVERSITARE

(Master of Arts)

TITULLI I PROGRAMIT:

STUDIME PËR TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

FAKULTETI JURIDIK

| | |
|---|--|
| 1. Institucioni/organi për dhënien titullit | Universiteti i EJL-së |
| 2. Institucioni arsimor | Universiteti i EJL-së |
| 3. Vendi i mbajtjes së mësimit | Kampusi i UEJL-së (Tetovë) |
| 4. Program i akredituar nga: | Këshilli i akreditimit |
| 5. Grada finale shkencore | M.A. |
| 6. Programi | Studime për të drejtën publike ndërkombëtare |
| 7. Data e përpunimit/revizionit | Shtator 2007 |
| 8. Grupi i studentëve | Gjenerata e vitit akademik 2008/2009 |

9. Qëllimet mësimore të programit

10. Deri në mbarimin e programit, studentët do të pajisen me njohuri dhe do t'i kuptojnë të gjitha segmentet e së drejtës ndërkombëtare, siç janë: të drejtat e njeriut, organizatat ndërkombëtare Kombet e Bashkuara dhe organet e saj, funksionimi i institucioneve të së drejtës ndërkombëtare dhe krijimi i tyre, drejta humanitare, rregullat qenësore relevante për sferat kyçe të së drejtës ndërkombëtare, perspektivat teorike dhe debatet akademike, të cilat në mënyrë qenësore i vënë në dukje sferat juridike, aspektet kyçe, problemet juridike dhe parimet lidhur me ratifikimin e konventave të caktuara ndërkombëtare në vendet anëtare;

Pas përfundimit të programit, studentët do të mund:

- Me sukses t'i zbatojnë njohuritë e fituara nga drejta ndërkombëtare në shumë situata ku shqyrtohen problemet relevante praktike ose teorike;
- T'i vlerësojë problemet në bazë të kontekstit, relevancës dhe rëndësisë të tyre dhe t'i ndërlidh informacionet relevante dhe burimet kyçe nëpërmjet mjeteve elektronike ose mjeteve tjera;
- T'i vlerësojë problemet dhe të gjejë zgjidhje për lidhur me zbatimin e të drejtës penale në shtet, t'i formulojë argumentet për problemet kryesore dhe sferat kontraverze dhe të prezantojë mendim racional të bazuar në materiale relevante;
- T'i njohë argumentet potenciale alternative dhe dëshmitë kundërthënëse sipas mendimit të vetë dhe t'i prezantojë;
- Të demonstrojë mendimin e lirë dhe aftësi për të ofruar nxitje kritike për njohuritë e fituara për probleme individuale.
- Të kontribuojë në mënyrë konstruktive në progresin shkencor.

11. Rezultati e nxënies së mësimit

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE NDËRKOMBËTARE

Cikli i dytë i programit për të drejtën publike ndërkombëtare do të ofrojë njohuri solide dhe kuptim sistematik për strukturat institucionale, parimet kyçe juridike dhe kontekstet e caktuara të së drejtës ndërkombëtare.

Njohuritë e fituara

Ligjëratat/mësimi, metodat dhe strategjitë e vlerësimit të cilat përdoren për arritjen dhe prezentimin e rezultateve

A. Njohuritë e fituara dhe shqyrtimet

Ligjëratat/mësimi

1. Programi do t'ju mundësojë studentëve fitimin e shkathtësive për t'u ballafaquar me problemet juridike, me ratifikimin e instrumenteve juridike ndërkombëtare dhe do t'i nxit studentët në zhvillimin e vetëdijes kritike për funksionimin e Kombeve të Bashkuara dhe organizatave tjera ndërkombëtare.

Ligjëratat do të ndiqen nëpërmjet tri orëve të seminare, të cilat do të mbahen çdo të ditën javë. Në fillim të ligjëratave, ligjëruesi do ta paraqes kontekstin e përgjithshëm të lëndës dhe ekspozenë e problemeve kyçe dhe do t'i vë në dukje sferat për të cilat do të diskutohet në të ardhmen. Këtë hyrje që do ta gjejnë studentët në literaturën e rekomanduar, ka për qëllim t'i fokusojë seminarët në diskutime të hollësishme për tema të caktuara, thjeshtë të bazuara në prezantime dhe ese nga ana e studentëve dhe aplikimi i diskutimeve për probleme kritike. Prezantimet kërkojnë nga studentët të formojnë pikëpamjet e tyre për fushën përkatëse dhe të zhvillojnë diskutime me ligjëruesin dhe me kolegët.

2. Programi është hartuar me qëllim të zhvillimit të shkathtësive nga sfera e hulumtimeve juridike akademike, posaçërisht përmes prezantimit me shkrim të argumenteve në frymën e integritit të vlerave relevante akademike dhe t'ju ndihmojë atyre studentëve të cilët mendojnë vazhdimin e studimeve të tyre në një nivel më të lartë, në fitimin e një baze të mirë për teknikat e domosdoshme dhe për metodat hulumtuese të cilat janë pjesë e lëndëve të specializuara.

3. Ky program do t'ju mundësojë studentëve kualifikime të vlefshme pasuniversitare, sidomos atyre që kanë për qëllim të marrin rolin udhëheqës në procesin e integritit të vendit tone në rrjedhat botërore dhe zhvillimin e shkathtësive ekonomike të atyre studentëve, të cilët pas diplomimit janë të interesuar për t'u punësuar në sektorët e politikës së jashtme dhe në organizatat ndërkombëtare.

Vlerësimi

Vlerësimi i njohurive të fituara nga lëndët dhe kombinimi provimeve me shkrim (kolokuiume dhe provimi final) esetë e përbërë prej 4000 deri më 5000 fjalë, të cilat patjetër duhet të dorëzohen për çdo lëndë të ndjekur, kolokuiumi dhe provimi final. Pjesa tjetër e programit kërkon nga studentët të hulumtojnë, të shkruajnë dhe ta dorëzojnë disertacionin e bërë prej 15.000 deri më 20.000 fjalë, pas caktimit paraprak të temës nga fusha e së drejtës ndërkombëtare, dhe nën mbikëqyrjen e një anëtari të kuadrit akademik me përvojë nga fusha përkatëse

B. Shkathtësitë dhe karakteristikat tjera

Aftësitë për bartjen e shkathtësive *Ligjëratat/mësimi* intelektuale.

Pas kryerjes me sukses të programit studentët mund:

1. Të fitojnë shkathtësi në ballafaqimin me problemet juridike lidhur me ratifikimin e instrumenteve ndërkombëtare juridike dhe të zhvillojnë vetëdijen kritike për funksionimin e Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave tjera ndërkombëtare.
2. Ta zhvillojnë vetëdijen kritike për funksionimin e institucionit të së drejtës publike.
3. Ta vazhdojnë karrierën e tyre në të drejtën ndërkombëtare dhe në diplomaci.

| C.Aplikimi i shkathësive speciale: | Ligjëratat/mësimi |
|---|--|
| <p>Aplikimi dhe zgjidhja e rasteve juridike</p> <p>Pas përfundimit me sukses të programit, studentët mund:</p> <p>a) Me hulumtimin dhe përgatitjen e disertacionit t'i zhvillojnë shkathësitë hulumtuese. Mbikëqyrja gjatë përgatitjes së disertacionit ju mundëson studentëve të mendojnë në mënyrë individuale dhe progresive;</p> <p>b). Të zhvillojnë një nivel të lartë përmes disertacioneve të tyre dhe, njëkohësisht ju mundëson që shkathësitë e ndryshme të studentëve të vinë në shprehje bashkë me punimin e shkruar të magistraturës;</p> <p>c) T'i identifikojnë rastet në bazë të përvojave të mëhershme juridike;</p> <p>ç) Të mendojnë për shkakun dhe të jenë të informuar mirë për veprimet e mundshme ligjore, të cilat rrjedhin nga ky mendim, si dhe nga mundësitë e suksesit.</p> | <p>Vlerësimi</p> <p>Vlerësimi Aftësia për zgjidhjen e problemeve juridike kryesisht zhvillohet përmes përgatitjes dhe pjesëmarrjes në orët e këtij programi.</p> <p>Pas seminareve të mbajtura në gjuhën angleze nga ana e kuadrit ndërkombëtar për së afërmi njihen me metodat mësimore juridike të lejuara në vendet e Europës Perëndimore dhe universitetet amerikane.</p> <p>Vlerësimi Vlerësimi bëhet në pyetjet e shtruara rreth lëndës konkrete në provimin me shkrim dhe në vlerësimin e lëndës, duke i përfshirë edhe testet në orë</p> |

Ç. Shkathtësitë themelore:

Komunikimi dhe shkrimi

Ligjëratat/mësimi

Pas kryerjes me sukses të programit studentët aftësohen:

a) Të fitojnë me shkathtësi të rëndësishme të komunikimit, posaçërisht ata të cilët janë të interesuar për t'u punësuar në pas kryerjes së studimeve pasuniversitare nga fusha e së drejtës ndërkombëtare dhe diplomacisë.

b) Ta shfrytëzojnë gojarisht/me shkrim gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze, lidhur me çështjet rreth sferës të së drejtës publike ndërkombëtare;

c) Të angazhohen në mënyrë efikase dhe konstruktive në dëshmitë dhe diskutimet për çështjet komplekse në gjuhën shqipe, maqedonase dhe në gjuhën angleze;

ç) Të bëjnë prezantimin e qartë dhe koherent për ndonjë temë ose detyrë, duke përdorur materiale të ndryshme;

d) Aftësohen t'i lexojnë materiale komplekse të cila janë ose nuk janë të lidhura me sferën e të drejtës publike ndërkombëtare.

Vlerësimi

Punimet e seminarit, prezantimet në orë, diskutime. Përgatitjet, të shkruarit dhe reflektimi nga vlerësimi i lëndës së shkruar, duke e përfshirë edhe doktoratën.

Vlerësimi

Vlerësimi i lëndës së shkruar, vlerësimi i prezantimeve në orë, si dhe realizimi i punës së vlerësuar praktike. Provimi me gojë dhe me shkrim.

11. Struktura e programit studimor, kushtet e studimit, niveli, moduli, kreditë

Studime pasuniversitare nga fusha e së drejtës publike ndërkombëtare do të zgjasin (2) vite akademike, përkatësisht tre semestra, të përbërë nga pesë lëndë dhe një semester teza e magistraturës. Lëndët në semestra janë të obligueshme, ndërsa të tjerat janë zgjedhore. Çfo lëndë e dëgjuar, dhe me sukses është kaluar në provim, studentit do t'i sjell 6 (gjashtë) kredi, kurse teza e magistraturës do t'i sjell 30 kredi. Kjo donë të thotë se për kryerjen me sukses të studimeve pasuniversitare janë të nevojshëm 120 kredi. Secila lëndë duhet të kryhet duke i plotësuar edhe kërkesat e shtruara në silabusin (programin) e lëndës.

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE NDËRKOMBËTARE

PRORAMI STUDIMOR I STUDIMEVE PASUNIVERSITARE

| <i>Semestri 1</i> | <i>Kreditë</i> | <i>Dim ëror/ Veror</i> | <i>Orët teorike</i> | <i>Orët prakti ke</i> | <i>Gjithsej Orët studimore</i> | <i>Madhësia e grupeve</i> |
|-------------------------------------|----------------|--------------------------------|-------------------------|-------------------------------|--|-------------------------------|
| Gjuhë angleze | 6 | D | 22 | 22 | 180 | |
| Metodologjia e së drejtës | 6 | D | 22 | 22 | 180 | |
| E drejta publike ndërkombëtare 1 | 6 | D | 22 | 22 | 180 | |
| Marrëdhëniet ndërkombëtare 1 | 6 | D | 22 | 22 | 180 | |
| Lënda zgjedhore | 6 | D | 22 | 22 | 180 | |
| Gjithsej | 30 | | | | 900 | |

| <i>Semestri 2</i> | <i>Kreditë</i> | <i>Dim ëror/ Veror</i> | <i>Orët teorike</i> | <i>Orët prakti ke</i> | <i>Gjithsej Orët studimore</i> | <i>Madhësia e grupeve</i> |
|--|----------------|--------------------------------|-------------------------|-------------------------------|--|-------------------------------|
| E drejta publike ndërkombëtare 2 | 6 | V | 22 | 22 | 180 | |
| E drejta humanitare | 6 | V | 22 | 22 | 180 | |
| Marrëdhëniet ndërkombëtare 2 | 6 | V | 22 | 22 | 180 | |
| E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut | 6 | V | 22 | 22 | 180 | |
| Lënda zgjedhore | 6 | V | 22 | 22 | 180 | |
| Gjithsej | 30 | | | | 900 | |

| <i>Semestri 3</i> | <i>Kreditë</i> | <i>Dim ëror/ Veror</i> | <i>Orët teorike</i> | <i>Orët prakti ke</i> | <i>Gjithsej Orët studimore</i> | <i>Madhësia e grupeve</i> |
|------------------------------------|----------------|--------------------------------|-------------------------|-------------------------------|--|-------------------------------|
| E drejta diplomatik | 6 | D | 22 | 22 | 180 | |
| E drejta private ndërkombëtare | 6 | D | 22 | 22 | 180 | |
| E drejta penale ndërkombëtare | 6 | D | 22 | 22 | 180 | |
| E drejta tregtare ndërkombëtare | 6 | D | 22 | 22 | 180 | |
| Lënda zgjedhore | 6 | 3 | 22 | 22 | 180 | |
| Gjithsej | 30 | | | | 900 | |

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE NDËRKOMBËTARE

| <i>Semestri 4</i> | <i>Kreditë</i> | <i>Dim ëror/ Veror</i> | <i>Orët teorike</i> | <i>Orët prakti ke</i> | <i>Gjithsej Orët studimore</i> | <i>Madhësia e grupeve</i> |
|-------------------------|----------------|--------------------------------|-------------------------|-------------------------------|--|-------------------------------|
| Punimi i magjistraturës | 30 | V | | | 900 | |
| Gjithsej | 30 | | | | 900 | |

Lëndët zgjedhore:

- Tregtia me njerëz dhe të drejtat e njeriut
- Arbitrazhi ndërkombëtar
- E drejta ndërkombëtare e mjedisit jetësor
- E drejta e detarisë
- Organizatat ndërkombëtare

PËRSHKRIMI I LËNDËVE TË OBLIGUESHME

SEMESTRI 1

Metodologjia e së drejtës

Lënda i studion metodat e njohjes së të drejtës dhe llojet e saj, si dhe metodat e krijimit, interpretimit dhe zbatimit të së drejtës, të cilat janë të domosdoshme për procesin hulumtues në të gjitha sferat juridike dhe në të gjitha nivelet e arsimimit akademik.

E drejta publike ndërkombëtare 1 dhe 2

Lënda E drejta publike ndërkombëtare studion të drejtën ndërkombëtare, duke filluar nga krijimi i saj në suaza historike dhe zhvillimin e saj deri më sot. Kjo lëndë i analizon rrjedhat politike në suaza botërore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare. Gjithashtu, i përkufizon sgrat e caktuara të së dejtës ndërkombëtare, siç janë burimet e të drejtës ndërkombëtare, të drejtat e njeriut, të drejtën e kontratave dhe të koventave, të drejtën detare, të drejtën diplomatike dhe të ngjashme.

Marrëdhëniet ndërkombëtare

Lënda Marrëdhëniet ndërkombëtare i studion qeveritë e shteteve në botë, përkatësisht vendimet e tyre në raport me qeveritë tjera. Këto vendime në masë të madhe varen nga vetë shtetet, si dhe nga aktorët tjerë, siç janë: Organizatat ndërkombëtare, kompanitë multinacionale, grupet e lobimit, organizatat terroriste dhe personat fizik. Gjithashtu, ndikim madh kanë edhe historia dhe gjeografia, si dhe faktorët tjerë plotësues. Siguria ndërkombëtare është materie tradicionale e studimit të kësaj lënde.

SEMESTRI 2

E drejta humanitare

Lënda E drejta humanitare e studion të drejtën humanitare ndërkombëtare, përkatësisht të drejtën e cila vlen gjatë kohës së luftës dhe ka të bëjë me mbrojtjen e robërve të luftës, popullatën civile, dhe objektet historike dhe mjekësore. Lënda i studion konventat e Gjenevës, me protokollet e saj dhe rrjedhat e reja zhvillimore të implementimit të këtyre rregullave përmes tribunaleve ndërkombëtare.

E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut

Kjo lëndë e analizon të drejtën ndërkombëtare të së drejtave të njeriut që nga themelimi dhe zhvillimi i saj në botë, e deri më sot. Lënda i përfshinë instrumentet më të mëdha dhe më të rëndësishme siç janë: Konventa evropiane për të drejtat e njeriut, Pakti ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave politike dhe të qytetarëve, Pakti ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave ekonomike dhe sociale dhe Konventën e mbrojtjes së grave nga çfarëdo lloji diskriminimi. Gjithashtu, lënda i studion mekanizmat e zbatimit të këtyre instrumenteve ndërkombëtare.

SEMESTRI 3

E drejta diplomatike

Kjo lëndë e studion kornizën juridike të marrëdhënieve ndërkombëtare në nivel ndërkombëtar. Ndërkaq, pas analizës së zhvillimit historik të këtyre marrëdhënieve dhe zhvillimit të rregullave juridike për rregullimin e tyre në nivel ndërkombëtar, janë

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE NDËRKOMBËTARE

përqendruar edhe në studimin e Konventës së Vienës, duke vënë në dukje shembuj të diplomacisë evropiane.

E drejta private ndërkombëtare

E drejta ndërkombëtare private si degë juridike e sistemit juridik pozitiv të shtetit të caktuar, i rregullon marrëdhëniet private juridike me një element të huaj dhe i parashikon mënyrat e rregullimit të tyre. I studion burimet nacionale dhe ndërkombëtare për rregullimin këtyre marrëdhënieve, si dhe hierarkinë e burimeve nga aspekti i prioriteteve të zbatimit të tyre në rregullimin e marrëdhënieve që përmes subjektit ose objektit, ose të drejtat dhe obligimet janë të ndërlidhura edhe me sovranitetin e shteteve të huaja. Gjithashtu, kjo lëndë mundëson njohuri përmbajtjesore për tërësitë që e formojnë këtë degë të drejtësisë, edhe atë: tërësinë e të drejtave civile të shtetasve të huaj që të mund në territorin e shtetit të vetë të themelojnë marrëdhënie private juridike m element të huaj; tërësinë e të drejtave civile të shtetasve vendës që të mund të themelojnë marrëdhënie civil-juridike me element të huaj; tërësinë e kolizionit të juridiksioneve; si dhe tërësia e kolizionit të ligjeve.

E drejta penale ndërkombëtare

Kjo lëndë e studion evolucionin e së drejtës penale ndërkombëtare nga Ninbergut dhe Tokio, e deri në zhvillimin e tribunalit ndërkombëtar për Ruandën dhe për ish Jugosllavinë dhe themelimin e Gjyqit ekzistues penal ndërkombëtar në Hagë (Statuti i Romës 1998). Kjo lëndë i analizon gjykimet transnacionale, si atë të Pinoçes, dhe qëllimi i saj është të ofrojë informacione të hollësishme për disa doktrina fundamentale të përgjegjësisë penale ndërkombëtare dhe shfrytëzimin e modeleve procedurale për gjykimin e këtyre rasteve. Me këtë rast, vëmendje do t'u kushtohet edhe koncepcioneve të gjenocidit, veprave penale kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës.

E drejta tregtare ndërkombëtare

Kjo lëndë i studion institucionet ndërkombëtare, të cilat i krijojnë rregullat e tregtisë ndërkombëtare, marrëdhëniet midis shteteve dhe politikave të realizuara për tregti me njerëz. Vend qendror do të zë analiza e Organizatës Botërore të Tregtisë, politika e Bankës Botërore dhe të ngjashme.

PËRSHKRIMI I LËNDËVE ZGJEDHORE

Tregtia me njerëz dhe të drejtat e njeriut

Kjo lëndë i studion zhvillimin e problemeve botërore dhe aktualizimin e tyre në nivel ndërkombëtar dhe nacional. Pas një analize të shkurtër të zhvillimit historik për këtë çështje, kjo lëndë i studion instrumentet moderne ndërkombëtare në nivel ndërkombëtar dhe rajonal për rregullimin e këtij problemi, duke potencuar me këtë rast lidhshmërinë e saj me marrëdhëniet penalo-juridike në shoqëri, duke i analizuar në mënyrë përfundimtare dispozitat ekzistuese juridike që i ofron legjislatura jonë në luftë kundër këtij lloji të kriminalitetit.

Arbitrazhet ndërkombëtare

Lënda i analizon problemet në tregtinë ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ekonomike me karakter ndërkombëtar dhe zgjidhjen e tyre në nivelin ndërkombëtar, përmes gjyqeve të arbitrazhit.

E drejta ndërkombëtare e ambientit jetësor

Kjo lëndë e studin të drejtën ndërkombëtare të ambientit jetësor dhe zhvillimin e tij. Kjo shkencë si disiplinë e re ofron numër të limituar të së drejtës ndërkombëtare të kontratave detyrimore dhe shumë deklaracione, të cilat do të studiohen si pjesë e kësaj lënde.

E drejta e detarisë

Kjo lëndë studion zhvillimin e kësaj pjese të së drejtës ndërkombëtare, e cila është ndër fushat më të vjetrat dhe më të zhvilluara. Lënda i analizon rregullat zakonore të së drejtës detare dhe konventat ndërkombëtare të cilat i rregullojnë sferat e caktuara të kësaj të drejte.

Organizatat ndërkombëtare

Kjo lëndë e analizon interaksionin midis organizatave ndërkombëtare dhe qeverive të shteteve, si dhe organizimin dhe funksionimin e organizatave ndërkombëtare, midis të cilave edhe organizata më e rëndësishme ër ruajtjen e paqes dhe rendit në botë.